
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 07/08/2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës:

“Blerje mobilje dhe pajisje për institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)”, ndarë në 3 (tre) lote:

Loti 1-“Blerje Mobilje për institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)”

Loti 2- “Blerje Kondicionere për AKAFPK”

Loti 3 – “Pajisje për kontrollin e hyrje-daljeve të stafit të AKAFPK”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

Mobilje- 39100000-3

Pajisje të ndryshme- 39300000-5

Pajisje të ajrit të kondicionuar - 39717200-3

Vlera e fondit limit: “Blerje mobilje dhe pajisje për institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)”, 39,138,166 (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 419,937.40 (katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë pikë dyzet) euro pa TVSH, ndarë në 3 (tre) lote:

Loti 1-“Blerje Mobilje për institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)” me fond limit: 38,280,356.00 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 410,733.43 (katërqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e tre) euro pa TVSH.

Loti 2- “Blerje Kondicionere për AKAFPK”, me fond limit 345,144 (treqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH ose 3,703.26 (tre mijë e shtatëqind e tre pikë njëzet e gjashtë) euro pa TVSH

Loti 3 – “Pajisje për kontrollin e hyrje-daljeve të stafit të AKAFPK” me fond limit 512,666 (pesëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ose 5,500.71 (pesë mijë e pesëqind pikë shtatëdhjetë e një) euro pa TVSH

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 06/08/2026 është 93.20 (nëntëdhjetë e tre pikë njëzet) euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme janë të njëjta për të gjitha lotet

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Loti 1-“Blerje Mobilje për institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)” me fond limit: 38,280,356.00 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e qjashtë) lekë pa TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurren. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar*

kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2023, 2024,2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe

kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a)Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b)Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” / ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikatat e cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme

3.Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë stafin me kualifikimet si më poshtë:

1 (një) inxhinier druri, në rast se është prodhues vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (të vlefshme);
-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

2 (dy) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (të vlefshme);
- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

4 (katër) punonjës të thjeshtë për veprimtari ndihmëse ngarkim-shkarkim vërtetuar me:
-kontratën individuale të punës (të vlefshme);

-Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, sipas formës së parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Shenim: Kriteri nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar në të cilën përcaktohet : 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kërkesë është vendosur duke u referuar gjithashtu në nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë prodhues të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Arsyetimi i rëndësisë së profesioneve të zgjedhura:

- 1 (një) inxhinier druri.

Sigurimi i cilësisë, qëndrueshmërisë dhe plotësimi i standarteve të produkteve: Një inxhinier druri ka aftësitë dhe njohuritë për të analizuar, përzgjedhur dhe trajtuar materialet e drurit, për të siguruar që mobiljet janë të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ai mund të sigurojë që lëndët e para të përmbushin specifikimet teknike dhe që produkti përfundimtar të jetë i cilësisë së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Mobiljet kanë të specifikuar disa standarte, dhe një inxhinier druri ka njohuritë e duhura për t'i zbatuar këto standarte gjatë procesit të prodhimit të tyre. Ai është i kualifikuar për të ndihmuar në përzgjedhjen e konstruksioneve të përshtatshme që sigurojnë stabilitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e produkteve. Një inxhinier druri mund të mbykqyrë aspekte të sigurisë për produktet përfundimtare, që ato nuk paraqesin rrezik për përdoruesit e tyre. Rëndësia e kërkesës për staf të kualifikuar, për një inxhinier druri, qëndron në garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike, për të reduktuar kostot dhe për të ofruar siguri dhe qëndrueshmëri në përdorimin e produkteve nga Autoritet Kontraktore përfituese në këtë procedurë prokurimi

2 (dy) marangozë/ mobilierë/ montues mobiljesh:

Dy marangozë/ mobilierë/ montues mobiljesh/ përpunues druri kanë njohuritë e duhura në lidhje me përpuniminin edhe montimin e saktë të pjesëve të mobiljeve duke zbatuar me saktësi udhëzimet teknike dhe duke siguruar që çdo pjesë e montuar të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara. Këto specialistë ndikojnë drejtpërdrejtë në shmangjen e gabimeve që ndikojnë në cilësinë dhe jetëgjatësinë e mobiljeve, duke ulur riskun e defekteve dhe problemeve gjatë përdorimit. Cilësia, stabiliteti dhe siguria janë thelbësore për mobiljet pasi do të përdoren në institucionet e Arsimit Profesional (Shkollat Profesionale dhe AKAFPK)”. Gjithashtu specialistë të tillë sigurojnë që montimi/ asemblimi apo procese të tjera të punës të kryhen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Punonjësit e tjerë si punonjësit e thjeshtë janë të domosdoshëm për transportin dhe punën ndihmëse që do të kryhet përgjatë të gjithë proceseve të zbatimit të kontratës. Shpërndarja në 19 shkolla profesionale të cituara në listen e shpërndarjes bashkëlidhur DST-së kërkon një fuqi punëtore të dedikuar në terren. Katër punonjës janë numri minimal për të përballuar volumet e mëdha dhe shkarkimin e shpejtë të mallrave në adresat e autoriteteve kontraktore përfituese .

Këto mallra, në pjesën më të madhe të tyre nuk gjenden lirisht në treg me përmasat dhe specifikimet që kërkohen nga Autoritetet Kontraktore, pra objekti i prokurimit ka si proces prodhimin ose porosinë, e cila bëhet sipas Specifikimeve Teknike tek një prodhues, montimin ose asamblimin e mobiljeve, transportin dhe vendosjen e tyre në ambientet e 19 (nëntëmbëdhjetë) autoriteteve përfituese.

Ky numër punonjësish është minimale që operatori ekonomik ofertues, jo vetëm prodhues por edhe tregëtues, duhet të kenë për zbatimin e kontratës. Kjo krijon bindjen e Autoritetit kontraktor se operatori ekonomik duke patur një staf të kualifikuar, garanton që operatori ekonomik ka kapacitete për finalizimin me sukses të produkte përfundimtare cilësor, të qëndrueshme dhe jetëgjatë, të punuara në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe me standartet e kërkuara në dokumentet e tenderit.

4.Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi (loti 1) ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Gjithashtu katalogët/broshurat/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues në listën e shpërndarjes.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e Autoritetit Kontraktor Perfitues. Kjo i jep siguri Autoritetit Kontraktor Perfitues që operatori ekonomik do të realizojë me sukses kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron.. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku citohet: Neni 77/pika 3: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Neni 43/pika 2/germa : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbikufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi (loti 2) ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknike;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Gjithashtu katalogët/broshurat/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin dhe instalimin e mallrave objekt prokurimi Loti 2.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë transportin dhe instalimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e Autoritetit Kontraktor Përfitues. Kjo i jep siguri Autoritetit Kontraktor Përfitues që operatori ekonomik do të realizojë me sukses kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 3 – “Pajisje për kontrollin e hyrje-daljeve të stafit të AKAFPK”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga

ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron.. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku citohet: Neni 77/pika 3: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Neni 43/pika 2/germa b : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % i vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose

lotit, në procedurat e prokurimit mbikufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi (loti 3) ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Gjithashtu katalogët/broshurat/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin, instalimin dhe konfigurimin e mallrave objekt prokurimi Loti 3.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë transportin, instalimin dhe konfigurimin e mallrave objekt prokurimi në adresën e Autoritetit Kontraktor Përfitues. Kjo i jep siguri Autoritetit Kontraktor Përfitues që operatori ekonomik do të realizojë me sukses kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre. Në çdo rast për standardet e kërkuara do të pranohet edhe paraqitja e SSH/EN/ISO, të përditësuara për standardet ndërkombëtare të adaptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1	Tavolinë nxënësi cikli i lartë	Suprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i suprinës me skeletin duhet të bëhet me Vida të fshehta ose me preçina me kokë Ø4. Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me permasa 110 x 26 cm MDF e melaminuar 16 mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve. Montimi i syprinës me skeletin të bëhet me vida të fshehta. Në pjesën balllore të vendoset një element me përmasa 110 x 14.5 cm, me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht. Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku në të dyja anët e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të tavolinës, me seksion jo më të vogël 50 x 25 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubularoval ku në të dyja anët të rrumbullakosur jo më të vogël se 50 x 25mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20 x 20 mm, spesor jo më të vogël se 1.2 mm, e lyer me bojë elektrostatische ngjyrë sipas	120 x 75 x 45cm		Copë
---	---	---	-----------------	---	------

		kërkesës së klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023			
2	Karrige klase	Karriget të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil rrethor me diametër 21 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.3 mm të harkuar dhe lyer me fushë elektrostатike. Shpinorja dhe ndenjësja janë MDF ose me kompensatë, të cilat montohen në skeletin metalik me vida ose preçina. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)	Ndenjësja: 38 x 38 cm, Shpinorja : 18 x 41 cm, - Lartësia e karriges: 77 cm, - Lartësia e ndenjësës 44 - 46 cm.		Copë
3	Tavolinë pune e thjeshtë	Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njërin krah ndodhet posti i tastierës, e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtarë me gjerësi 45 cm ku sirtari i parë të	140 x 80 x 75 cm		Copë

		jetë i mbyllur me çelës. Montimi i tastierës duhet të jetë i thjeshtë dhe me mundësi zgjedhje të krahut të punës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)			
4	Karrige për kabine të	Lartësia 85 cm kurse lartësia e ndenjës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm. Dimensionet e ndenjës jo më pak se 40 x 40 cm. Skeleti të realizohet nga dru ah masiv me seksion katror ose i rrumbullakët, i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit. Ndenjësja të realizohet me pllake zdrukthi, sfungjer dhe stof. Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar. Në çdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure. Mbështetësja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023			Copë

5	Tavolinë zyre	Tavolina e punës përbëhet nga suprina dhe harku lidhës prej materiali pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm me borde anësore të plastifikuara me PVC 0.8 mm trashësi. Konstruksioni përbëhet nga materiali pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të padukshëm. Tavolina e punës mbështetet mbi këmbë plastike po ashtu skeleti i tavolinës së kompjuterit përbëhet nga pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm njësoj si pjesa tjetër dhe poshtë tavolinës vendoset një pjesë për mbajtjen e tastierës së kompjuterit. Komodina gjithashtu me pllakë zdrukthi të melaminuar 18 mm, mbështetet mbi rrota dhe ka tre sirtarë me doreza të hapshëm me shina ku sirtari i parë detyrimisht duhet të ketë edhe bravë. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 120 x 70 x 72 cm <i>Tavolin ë kompjuteri</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 90 x 70 x 72 cm Hark Lidhës 70 x 70 x 72 cm <i>Sirta rë kom odin e</i> (gjat ësi x gjer ësi x lartësi): 40 x 42 x 62 cm		Copë
6	Tavolinë për bibliotekë	Suprina e tavolinës duhet të jetë prej material pllakë zdrukthi e melaminuar 1.8 cm e borduar me PVC 0.8mm trashesi. Montimi i këmbëve me suprinën realizohet nëpërmjet një elementi lidhës për të siguruar qëndrueshmërinë e tavolinës me përmasa 112 x 35 cm, me melaminë 18 mm e borduar me PVC 0.8 mm. Këmbët e tavolinës duhet të jenë prej materiali pllakë zdrukthi e	Gjatësi a 120 cm, gjerësia 60 cm, lartësia 74 cm		Copë

		melaminuar 1.8 cm. Këmbët të jenë të vendosura mbi tapa plastike, të cilat lejojnë regjistrimin e lartësisë. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004			
7	Tavolinë nxënësi dyvendësh e për kompjuter - Arsimi i mesëm	Përmasat e tavolinës për desktop: Suprina 1400 x 700 x 750 mm; Skeleti 1350 x 650 x 725 mm; Dy çengela që ndodhen nga brenda për të varur çantat e nxënësve; Suprina e punës: pllake zdrukthi e melaminuar 18 mm e boeduar me PVC 0.8 mm që del mbi skelet; Skeleti është i ndërtuar me profil metalik tubular me seksion katror 30 x 30 mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm, këmbët metalike janë të pajisur me vida rregullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosnivele i dyshemesë. Nën suprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësisë qendrore e bërë me material pllake zdrukthi e melaminuar 18 mm me përmasa: 500 x 250 x 600 mm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023	Përmasat e tavolinës për desktop: Syprina 1400 x 700 x 750 mm; Skeleti 1350 x 650 x 725 mm		Copë
8	Tavolinë e veçantë për sallë mbledhjesh	Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC me trashësi 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës (suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që	200 x 90 x 75 cm		Copë

		përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).			
9	Tavolinë e veçantë për sallë mbledhjesh	Suprina pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC me trashësi 0.8 mm.. Bashkimi i planit të punës (suprinës) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Suprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 180 x 80 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 170 x 85 cm dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004	350 x 170 x 75 cm		Copë

10	Tavolinë ovale për sallë mbledhjesh	Suprina pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Suprina e tavolinës përbëhet nga 6 elementë. Katër elementë me përmasa 235 x 82.5 cm që vendosen paralelisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 70 cm midis tyre, dy elementët e tjerë janë në përmasa 235 x 105 cm dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).	680 x 235 x 75 cm		Copë
11	Tavolinë pune në formë L-je + Komodinë	Tavolina e punës: Suprina pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani	<i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x h-72 cm <i>Tavolinë pune</i> (gjatësi x gjerësi x lartësi): 160 x 70 x h-68 cm <i>Komodinë</i> me përmasa: 40 x 60 x		Set

		i dyshemesë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kablllove nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm. Komodina përbëhet nga 3 sirtarë me rrota lëvizëse, materiali pllakë zdrukthi e melaminuar 18 mm, ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).	h-68 cm		
12	Karrige statike me krahë mbështetës	Karrigia duhet të jetë me strukturë metalike, bazament mbështetës në forme U, me përmasa ndenjësja 46 cm x 47 cm, shpinorja të jetë në formë të harkuar me përmasa 60 cm x 48 cm. Gjatësia e shpinores duhet të zbresë poshtë nivelit të ndenjësës. Përmasat e bazamentit mbështetës 57 cm x 47 cm. Lartësia totale të jetë 94 cm. Shpinorja dhe ndenjësja duhet të jenë të veshura me lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018	60 x 40 x 80 cm		Copë
13	Karrige për salla konferenca sh	Karrige me strukturë metalike, me seksion tërthor tip tub oval 30x15 mm, me spesor $\delta = 1.5$ mm dhe lidhëza metalike tubolare me diametër $\varnothing=18$mm dhe trashësi $\delta=1.35$mm që bashkojnë këmbët, të cilat janë kurbuar. Ndërsa struktura e shpinës është kurbuar me kënd jo më i madh se 105°, në mënyrë që të formojë një qëndrim ergonomik ulëses dhe mbështetëses. Struktura metalike lyhet me bojë elektrostatische në temperaturën 200°, me ngjyrë të zezë. Fundi i			Copë


		këmbëve dhe anësoret e tyre mbulohen me tapa plastike. Ndenjësja dhe shpina janë me strukturë të qëndrueshme, të mbushur me sfungjer me densitet të lartë me trashësi 35 mm. Në pjesën e brendshme të veshura me tekstil ose lëkurë ekologjike, ndërsa në pjesën e jashtme mbulohen me kapak plastik të së njëjtës formë. Përmasa përfundimtare e ndenjësës 47 x 44 cm, më lartësi nga dyshemeja 45-50 cm, ndërsa shpinorja 47 x 35 cm, me lartësi nga dyshemeja 80 cm. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018			
14	Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës plastik	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018			
15	Karrige rrotulluese zyre me bazament dhe krah mbështetës metalik	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali metalik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë metalik dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof			Copë

		të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike.			
		Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018			
16	Dollap me dy kanata	Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm. Kanatet do të montohen me mentesha me thithje. Sergjenet do jenë prej materiali pllakë zdrukthi e melaminuar me trashësi 2.5 cm. Xokula do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira me sergjene me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015	90 x 45 x 210 cm		Copë
17	Raft për dosje (etazher)	Skeleti dhe sergjenet do jenë prej materiali pllake zdrukthi të melaminuar me trashësi 18 mm. Kapakët janë me material MDF me trashësi 18 mm të borduar me PVC me trashësi 0.8 mm. Xokola do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore plastike kundër gërvishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë, që mbyllen me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy hapësira me anë të një sergjene me	90 x 45 x 190 cm		Copë

		lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kornizë druri). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali të kromuar. Shpina e mobiljes me fiber 4 mm trashësi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015			
18	Raft metalik për dosje (arshivë)	Raftet kërkohen të jenë prej materiali metalik, me strukturë të qëndrueshme për mbajtje sasiore dokumentesh. Të jetë i ndarë me 4 sergjenë. Krahët mbajtës të jenë me vrima për vendosje raftesh horizontalë në nivele të ndryshme dhe me mbështetëse gome në pjesën fundore. Materiali i përdorur do të jetë llamarinë e zezë me spesor 0.9-1 mm. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015	90 x 40 x 200 cm		Copë
19	Dollap metalik me dyer (hapje formë flamuri)	Dollapi metalik duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që të rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Përbëhet nga dy kanata me hapje 90 gradë. Dyert janë me hapje në formë flamuri. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Trashësia e llamarinës jo më pak se 0.9-1 mm. Të plotësojë kërkesat e Standartit	92 x 40 x 195 cm		Copë

		EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015			
20	Garderobë 3 kanata	Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë me pllake zdrukthi të melaminuar, me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi 0.8 mm, me ngjyrën e materialit. Kanatet do të montohen me mentesha metalike me thithje që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokola do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Kanatet të mbyllen me çelës. Pjesa me dy kanate të ketë një ndarëse në pjesën e sipërme një varëse rrobash tub, një ndarëse në pjesën e poshtme. Pjesa e brendshme e kanatit tek të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira nëpërmjet 4 ndarëseve me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015	120 x 55 x 200		Copë
21	Raft për dosje, material MDF	Raftet do të realizohen me MDF, ku në pjesën e dukshme ajo do të jetë të veshur me rimeso druri si tavolinat e zyrës përkatëse dhe do të jenë të lyera me llak transparent me ngjyrë natyrale. Pjesa e poshtme do të jetë me kapakë me MDF me lyerje deri në lartësinë 75 cm dhe do të ndahet hapësira me	90 x 45 x 200 cm		Copë

		anë të një sergjëni. MDF që do të përdoret do të ketë spesor 18 mm. Dorezat do të realizohen me frezim. Duhet të kihet kujdes në montimin e pjesëve përbërëse, pasi nuk duhet të jenë në dukje vidat e bashkimit. Në pjesën e poshtme do të vendosen tapa fundore plastike me lartësi 3 cm në kontaktin me dyshtemenë. Pjesa e mbrapme e dollapit do të jetë me MDF me lyerje me trashësi 7 mm. Pjesa e sipërme do të jetë me kanata prej xhami me korniza inoksi 20 x 20 mm. Xhami do jetë transparent me trashësi 4 mm. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjeneve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015			
22	Kasaforta sekrete	Kasaforta duhet të ketë strukturë llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e pajisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete. Lyerja me fushë elektrostatike. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm.	50 x 50 x 110 cm		Copë

23	Rafte metalike	Skeleritë metalike të jenë prodhime cilësore dhe solide me material hekur “L”. Materiali “L”, të jenë prej hekuri cilësi e parë, me spesor jo më të vogël se 4 mm dhe gjerësi 40 mm. Këmbët të jenë 12 cm nga toka, ndarëset (sergjenet) të jenë çdo 50 cm të salduara në mënyrë që të mbajnë pesha të mëdha. Shtresat e sergjenet të jenë prej lllamarine me trashësi jo më pak se 1.2 mm e cilësi e parë, e punuar me forma që të mbajnë peshën e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë sergjenin, jo më pak se 120 kg. Hapësirat të jenë me përmasa 100 x 50 cm x 60 cm thellësi. Raftet të realizohen sipas përmasave të kërkuara dhe të kenë vrima të hapura për të krijuar mundësitë që të lidhen me njëri – tjetrin me vida dhe bulona. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015	100 x 60 x 250 cm		Copë
24	Poltron rrotullues (drejtuesi)	Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë. Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje. Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa. Duhet të ketë krahë anësore. Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Bazamenti duhet të jetë metalik ose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018			Copë

25	Poltron rrotullues	Bazamenti të jetë i ndërtuar në formë ylli nga pesë këmbë metalike të kromuara ose alumini me rrota të lëvizshme 360 gradë. Rrotat të jenë të përforcuar me material termoplastik (poliamide). Pistoni gazit për rregullimin e lartësisë të karriges të aktivizohet me levë që ndodhet poshtë dhe në anën e djathtë të ndenjësës. Mekanizmi i ndenjësës të jetë metalik dhe të lejojë lëvizjen e shpinës në pjerrësi të ndryshme. Rregullimi të arrihet duke tërhequr levën e vendosur më poshtë dhe në qendër të objektit. Ndenjësja duhet të jetë e prodhuar nga material polipropilen dhe e veshur me sfungjer dhe tapiceri të cilësisë së parë. Pjesa e sipërme e shpinores të jetë e veshur me tapiceri në formë rrjete. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018	60 x 40 x 80 cm		Copë
----	---------------------------	--	-----------------	--	------

Afatet e lëvrimit: 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës

Ky afat është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumin dhe kompleksitetin e mallrave objekt furnizimi, kohën e nevojshme për prodhimin, transportin, montimin dhe shpërndarjen e tyre pranë institucioneve përfituese .

Destinacioni/Vendi i dorëzimit: Sipas grafikut të shpërndarjes bashkëlidhur DST-së

Loti 2- “Blerje Kondicionere për AKAFPK”

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1	Kondicioner Inverter mural 12000 BTU/h 	Kondicioner Inverter Mural 12000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 3.5 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 5 kW; Fuqia elektrike 0.66-1.0 kW; SEER=8.7-9.1, SCOP=5.2-5.77; EER=5.1-5.35; COP=4.8-5.1; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 300-336 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 340-420 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 20-30 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklaratë konformiteti.	798 x 295 x 372 mm	Copë
2	Kondicioner Inverter mural 18000 BTU/h 	Kondicioner Inverter Mural 18000 BTU/h; Kapaciteti termik Ftohje Mesatar: 5.0 kW; Kapaciteti termik Ngrohje Mesatar 6.3 kW; Fuqia elektrike 1.10-1.41 kW; SEER=7.2-8.7, SCOP=4.3-5.6; EER=3.09-4.55; COP=3.5-4.47; Sasia e ajrit Mesatar ftohje: 500-865 m³/h; Sasia e ajrit Mesatar ngrohje: 580-995 m³/h; Niveli Zhurmës Minimumi 30-40 dB(A); Temperatura e punës Minimumi -15°C; Klasi Energjisë A+++ / A++ gaz R32, wifi. Të plotësojë kërkesat e Standartit EN/ISO Standard Compliance – zakonisht përputhshmërinë me standardet europiane si EN 14511, EN 378, EN 14825 (efikasitet energjetik, siguria e sistemeve ftohëse). RoHS / WEEE – për kufizimin e substancave të rrezikshme dhe riciklimin (fletët e pajtueshmërisë (Declaration of Conformity – DoC) nga prodhuesi. Pajisja duhet të ketë CE, ErP, etiketë energjetike dhe/ose deklaratë konformiteti.	798 x 295 x 372 mm	Copë

Afati i realizimit: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Afati i realizimit është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, e cila përfshin furnizimin, transportin dhe instalimin e pajisjeve nga operatori ekonomik fitues.

Destinacioni/Vendi i dorëzimit: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), Rruga “Mustafa Lleshi”, Godina e Thesarit, Kati III, Tiranë 1001, Albania.

LOTI 3 – “PAJISJE PËR KONTROLLIN E HYRJE-DALJEVE TË STAFIT TË AKAFPK”

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

Sistem Akses Kontrolli

- Sistemi duhet të jetë i aftë për t’u implementuar për një derë të vetme për të monitoruar hyrje-daljet.
- Zgjidhja për sistemin e akses kontrollit duhet të jetë e bazuar në TCP/IP ose RS-485 ose RS-232.
- Sistemi i aksesit të kontrollit duhet të përbëhet minimalisht nga elementet:
 - Një kontrollor i jashtëm ose i inkorporuar.
 - Një lexues kartash aksesi.
 - Një kundrabrave elektrike.
- Kontrolleri duhet të ofrojë të paktën opsione për ndërrim të kartës, shtimin apo heqjen e përdoruesve, etj.
- Lexuesi antivandal me IK10 dhe IP65.
- Te mbeshtesi të pakten teknologjite të kartave Mifare dhe RFID.
- Të sinjalizojë mbi gjendjen: Power/Status (Red/Green).
- Të suportojnë:
 - Shpejtesia e procesorit: minimalisht 1Ghz.
 - Numri i përdoruesve: min. 500;
 - Numri i kartave të vlefshme: min. 500;
 - Numri i ruajtjes së ngjarjeve: min 10 000 log-e;
- Distanca e leximit të kartës: 1 to 5 cm;
- Temperatura e operimit: -10°C~+40°C.
- Garanci: 3 vjet.

Karta aksesit:

Kartat duhet të jenë kompatibël me sistemin e Aksesit të Kontrollin më sipër.

Të jenë plastike dhe të personalizohen sipas kërkesës.

Sasia: 20 copë për laborator.

Afatet e lëvrimit: 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës

Afati i lëvrimit është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e pajisjeve, furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e sistemit.

Destinacioni/Vendi i dorëzimit: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), Rruga “Mustafa Lleshi”, Godina e Thesarit, Kati III, Tiranë 1001, Albania.

NJËSIA E PROKURIMIT